Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-9/26
24.09.2026
Mitrovice - Mitrovica

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-9/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 14, të Ligjit Nr. 03/L–040, Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/15, qershor 2008), nenit 5, 6, paragrafi 1.2, dhe nenit 8 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L–092, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/03, prill 2019); neni 4, 5 paragrafi 1.3 dhe 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës; nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 15, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 24.09.2026, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-463/06-0054953/26 të dt. 15.09.2026 sjell këtë:

VENDIM
Për miratim paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik/juridik (parcela Nr. 01870-5)

1. MIRATOHET Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik/juridik,
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është Parcela Kadastrale P-71208072-01870-5, në pronësi të Komunës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2151m^2, vendi i quajtur "Marshala Tita/Vojna Bolnica", Zona Kadastrale Mitrovicë (pronësi shoqërore).
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është realizimi i aktiviteteve ne fushën e zhvillimeve shëndetësore në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal. Sipas PZHK-së parcela e cekur më lartë është e destinuar si zonë e shërbimeve me destinim shëndetësi. Dhënia në shfrytëzim e kësaj parcele nuk duhet të cenojnë rendin publik, shëndetit publik, mjedisin dhe që nuk duhet të bie ndesh me legjislacionin në fuqi.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme, të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është afatgjatë për periudhën prej nëntëdhjetenëntë (99) vitesh.
5. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes njoftimit publik për shprehje të interesit sipas Ligjit Nr. 06/L–092, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës .
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Komisioni për vlerësim.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:
1 x 1 **Kryesuesit të Kuvendit**
1 x 1 **MAPL**
1 x 1 **Arkivit**
Kopje: **Kryetarit të Komunës**
Drejtorisë së Pronës
Komisionit Vlerësues